

**DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS**  
**POLITIKA NDAJ VEPRIMEVE BRUTALE**

**ÇFARE ESHTE SJELLJA BRUTALE?**

Sjellja brutale karakterizohet nga tre (3) kriteret e mëposhtëme:

1. Është sellje agresive, ose veprim për dëmtimin e **qëllimshëm** të dikujt.
2. kryhen në mënyrë të **përsëritur** për një farë kohe .
3. Çfaqen brënda një marrdhënie ndërpersonale, ku ekziston një mungesë **ekuilibri të forcës** (p.sh., një person është fizikisht më i madh, më i fortë, më i shpejtë mendërisht, ose me status social më të fortë).

Veprimet brutale mund të jenë veprime **direkte ose indirekte**, të cilat mund të përfshijnë (por nuk kufizohen me):

- **Fizike:** goditje, shkelmime, shtyrje, futja e një personi të tretë për të dëmtuar dikë;
- **Gojore:** sharje raciale, fyerje, tallje, thumbime, kërcënime verbale ose seksuale, bërja e thashethemeve, shpifjeve dhe përhapja e tyre; ose
- **Jo-Gojore:** kërcënime, gjeste të turpshme, izolime, përjashtime, ndjekje, kërcënime në internet (cyber-bullying), i cili është kërcënim, që ndodh përmes përdorimit të mjeteve elektronike apo të komunikimit si p.sh. emaileve, mesazheve të shpejta, mesazheve tekst, blogut, fotografive dhe videove, chat rooms, bash boards, websaiteve, etj.

**DREJTORIA NDALON TE GJITHA FORMAT E VEPRIMEVE BRUTALE NGA NXENESIT E DREJTORISE ARSIMORE**

**ÇFARE DUHET TE BENI KUR JU OSE DIKUSH TJETER PRANE JUSH ESHTE VIKTIME E SJELLJES BRUTALE?**

**Raportimi i incidenteve të Sjellje Brutale:**

Nxënësit ose prindërit/kujdestarët e nxënësve viktimë të veprimeve brutale, ose dëshmitarë të këtyre incidenteve, duhet të raportojnë menjëherë tek drejtori i shkollës ose i caktuari për këtë qëllim, ose te çdo punonjës i shkollës, përfshirë mësues, kujdestar, trajner dhe administrator. Çdo punonjës që merr informacion të tillë, duhet të njoftojë menjëherë drejtorin ose të ngarkuarin me këtë problem. Nëse sjellja vazhdon, ose nëse shkolla nuk merr masa, nxënësit (dhe/ose prindërit e tyre) duhet të raportojnë incidentin në linjën direkte të Drejtorisë Arsimore në numrin 215-400-SAFE.

**ÇFARE DO TE NDODHE PAS RAPORTIMIT TE NJE INCIDENTI TE VEPRIMEVE BRUTALE?**

1. Do të bëhet një hetim i shpejtë dhe i hollësishëm i raportimeve. Nëse akuzat janë të vërteta, Drejtori ose personi i ngarkuar i tij do të veprojnë si më poshtë:
2. Njofton nxënësin, që ka kërcënuar mbi rezultatin e hetimit;
3. Rishikon me të, kuptimin e veprimeve huligane dhe kërcënuese dhe politikat e Drejtorisë Arsimore lidhur me këto sjellje;
4. Ndëshkon sjelljen në bazë të numrit të shkeljeve dhe agresivitetit të veprimit; dhe
5. Njofton prindërit e nxënësit(ve) mbi veprimet dhe pasojat e kësaj sjellje agresive

**ÇFARE NDODH ME NXENESIN QE BEN VEPRIME BRUTALE?**

**Pasojat për Shkeljet e Konstatuara:**

Nxënësi, i cili ka shkelur politikat lidhur me kërcënimet apo veprimet brutale ndaj të tjerëve do t'i nënshtrohet ndërhyrjeve apo pasojave disiplinore të shkollës

- **Shkelja e Parë:** Paralajmërim me shkrim dhe njoftim i prindit;
- **Shkelja e Dytë:** Takim me prindin, humbje të privilegjeve në shkollë, përjashtim nga aktivitetet e shkollës, dënim, dhe/ose këshillim në shkollë;

**Shkelja e Tretë:** Pezullim nga mësimi apo transferim në një klasë tjetër, në një tjetër shkollë ose autobus.

Nëse shkelja e parë është e rëndë, për nxënësin duhet të merren menjëherë masa disiplinuese në bazë të Kodit të Sjelljes së Nxënësit. Kjo mund të çojë në një pezullim nga shkolla për një kohë të gjatë (4-10 ditë); referim për caktim në një program edukativ të shkollës alternative; ose përjashtim nga shkolla.

*Për më shumë informacion, kontaktoni Zyrën e Nxënësit, për Disiplinën, Dëgjimet dhe Përjashtimet, me numrin e telefonit*

*(215) 400-4230*

*Translation and Interpretation Center  
3/2011*

*Bullying Policy (Office of Academic Support)  
Albanian*